



- KOMUNA E KLINËS
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente
- 08.Nr. 357-839 /2026
- Klinë, datë 09.01.2026.

NJOFTIM PUBLIK PËR QYTETARËT

Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës,

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente, duke u bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore me nr. **01-Nr.112-681/2026** të datës **08.01.2026**, njofton të gjithë banorët që kanë pësuar dëme nga vërshimet e fundit se ka hapur procesin e pranimit të kërkesave për vlerësim.

Ftohen të gjithë qytetarët e prekur që të dorëzojnë kërkesat e tyre për daljen e komisionit në terren për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara.

Dokumentacioni i kërkuar për aplikim: Pala duhet të dorëzojë në arkivën e Komunës dokumentet e mëposhtme:

1. **Kërkesën me shkrim** (ku kërkon dalje në teren komisionit, dhe ku specifikohet lloji i dëmit,);
2. **Kopjen e letërnjoftimit** (valid);
3. **Konfirmimin bankar** (xhirllogarinë aktive);
4. **Foto dëshmi** të dëmeve të shkaktuara.
5. **Nr. Telefonit kontaktues.**

Vëmendje: Kërkesat që nuk i kanë pikat me larte, do të **REFUZOHEN** për arsye mos kompletimit të lendes.

Afati i fundit për dorëzim: Kërkesat duhet të dorëzohen më së largu deri me datën **19.01.2026**.

Ju inkurajojmë që t'i përmbaheni afatit të lartpërmendur në mënyrë që komisioni të ketë mundësi të bëjë vlerësimin e të gjitha rasteve në kohë rekord.

Me respekt,

Koordinator.

Shëndrit Gashi

